



KËSHILLI DREJTUES

VENDIM QARKULLUES

Nr. 37, datë 27.11.2020

**Për miratimin e një ndryshimi në
Vendimin e Këshillit Drejtues nr.19, datë 29.08.2013
“Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e
punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, i ndryshuar**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 52, pika 1, shkronja “g” të Ligjit nr.53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar, të nenit 6 pika 2, shkronja “q”, të nenit 7, pika 6, si dhe të nenit 8, pika 2, shkronja “f” të Statutit të Agjencisë, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 10, pika 6 të Rregullores të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit Drejtues nr. 19, datë 29.08.2013 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe numrin e punonjësve në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave” të ndryshuar, të bëhet ndryshimi si vijon:

1. Në aneksin 2 “Organika dhe përshkrimet e vendeve përkatëse të punës” bashkëlidhur vendimit, përshkrimi i punës për pozicionin “Specialist i shërbimeve mbështetëse” në Sektorin e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, të zëvendësohet me përshkrimin e punës sipas tekstit në aneksin nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sektori i Administratës dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar